



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
SENATI

Nr. 2793 prot.

Shkodër, më 25.09.2023

V E N D I M

Nr. 209, datë 25. 09.2023

"Për një ndryshim në Rregulloren e Studimeve në USH"

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, dt 22.07.2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", Neni 38 pika 1, germa "d"; Statutit të USH-së neni 17, pika 6, germa "r", Rregullores së Studimeve të USH-së, Senati akademik në mbledhjen e tij të datës 25.09.2023

Vendosi:

1. Të miratojë në nenin 34 shtimin e pikës 3, si vijon:
"Studenti i vitit të tretë dhe të katërt në një program studimesh të integruara që zgjasin pesë vite akademike, për të kaluar në vitin pasardhës, duhet të ketë grumbulluar nga viti që ndjek të paktën 25 pikë kredite".
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE

Prof. Dr. Rajmonda KËÇIRA

